



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 7 nëntor 2016
Nr. ref.:RK996/16

VENDIM PËR REFUZIMIN E KËRKESËS

në

rastin nr. KI71/16

Parashtrues

Ramadush Mjaku

**Kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë së vendimit të paspecifikuar
të autoritetit publik**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Artë Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga z. Ramadush Mjaku nga Sllatina e Poshtme, komuna e Vitisë (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston vendimin e paspecifikuar të autoritetit publik, por nuk specifikon detajet e atij vendimi, as nuk dorëzon vendimin e kontestuar.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar. Parashtruesi i kërkesës nuk ka përmendur asnjë të drejtë apo liri të garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), e cila mund të jetë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

Baza juridike

4. Kërkesa është bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji), dhe në rregullin 29 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 26 prill 2016, parashtruesi parashtroi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 11 maj 2016, Kryetarja caktoi gjyqtaren Selvete Gërxhaliu-Krasniqi gjyqtare raportuese. Të njëjtën ditë, Kryetarja caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Ivan Čukalović dhe Arta Rama-Hajrizi.
7. Më 13 korrik 2016, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi të dorëzojë vendimin e kontestuar të autoritetit publik për të cilin pretendon se kinse shkel të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë.
8. Më 20 korrik 2016, parashtruesi i kërkesës dorëzoi dokumente shtesë në Gjykatë. Megjithatë, në dokumentet e dorëzuara nuk gjendet vendimi i cili kontestohet nga parashtruesi.
9. Më 15 shtator 2016, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës, në përbërje të plotë, papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Parashtruesi i kërkesës pretendon se i kishte dorëzuar autoritetit publik të caktuar aplikacionin për pozitën e trajnerit në klubin lokal të futbollit, por aplikacioni i tij nuk është shqyrtuar asnjëherë dhe ai nuk është ftuar në intervistë.
11. Kështu, parashtruesi i kërkesës nuk ka paraqitur asnjë provë e cila e mbështet pretendimin e tij dhe asnjë informatë apo dëshmi që tregon se ai ka iniciuar

ndonjë procedurë ligjore apo që ka ndërmarrë ndonjë veprim tjetër për të mbrojtur të drejtat dhe liritë e tij.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

12. Parashtruesi i kërkesës, ndër të tjera, thekson: *“Në ankesën time për trajner futbollit të kryetari i komunës sime (të Ferizajt), kryetari pasi vërejti se është bërë një e padrejtë ndaj meje më sugjeroi që kryesinë e klubit të futbollit të Ferizajt ta padis në gjykatë. Mirëpo, pasi u konsultova me avokatin tim vendosa të mos aplikoj përmes gjykatës komunale të Ferizajt pasi që avokati më tha se kjo mund të zgjasë shumë, me vite të tëra. Prandaj unë duke pasur një përvojë të hidhur nga e kaluara me gjykatën, unë hoqa dorë”.*
13. Më tej, parashtruesi i kërkesës kërkon: *“Realizimin e tri kërkesave të mijë ligjore për të cilat i plotësoj të gjitha kriteret sipas ligjeve të Republikës së Kosovës dhe ligjeve ndërkombëtare sepse unë si profesor me përvojë të gjatë i njoh mirë ligjet dhe kërkoj realizim. Për informata jo të sakta jam i gatshëm për përgjegjësi penale para ligjit”.*

Pranueshmëria e kërkesës

14. Gjykata fillimisht shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.
15. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, të cilat përcaktojnë:

“(1) Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

(7) Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

16. Gjykata po ashtu i referohet nenit 48 të Ligjit, i cili përcakton:

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

17. Më tutje, Gjykata i referohet rregullit 29 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

“(2) Kërkesa, po ashtu, duhet të përmbajë edhe:

[...]

(f) përmbledhjen e shkurtër të fakteve;

(g) arsyetimin procedural dhe substantiv të kërkesës; dhe

(h) informacionet dhe dokumentacionin mbështetës”.

18. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se parashtruesi nuk ka përmbushur asnjë nga kushtet e kërkuara me dispozitat e lartpërmendura të Kushtetutës, të Ligjit dhe të Rregullores së punës.
19. Më konkretisht, Gjykata vëren se parashtruesi, përveç kërkesës së tij të përgjithshme dhe abstrakte, i) nuk ka kontestuar asnjë vendim konkret të ndonjë autoriteti publik; ii) nuk ka dëshmuar se ndonjëra nga të drejtat dhe liritë e tij të garantuara me Kushtetutë është shkelur nga ndonjë autoritet publik; iii) nuk ka paraqitur asnjë fakt apo të dhënë lidhur me rastin e tij; iv) nuk ka paraqitur asnjë arsyetim procedural ose substantiv të kërkesës së tij; v) nuk ka paraqitur asnjë informacion ose dokumentacion mbështetës; si dhe vi) nuk ka shteruar asnjë mjet juridik të parashikuar me ligj.
20. Në bazë të këtyre fakteve, Gjykata i referohet edhe rregullit 32 (5) (Tërheqja, hedhja poshtë dhe refuzimi i kërkesës) të Rregullores së punës, i cili parasheh:
- “(5) Gjykata mund të refuzojë një kërkesë me procedurë të shkurtë në qoftë se kërkesa është e paplotë ose e paqartë përkundër kërkesave nga Gjykata ndaj palës që ta plotësojë ose qartësojë kërkesën, nëse kërkesa është përsëritje e një kërkesë të mëparshme të vendosur nga Gjykata, ose në qoftë se kërkesa është joserioze”.*
21. Lidhur me këtë, Gjykata konkludon se kërkesa në fjalë nuk përfaqëson një rast ose kontest dhe nuk paraqet asnjë rrethanë të veçantë që lidhet me të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me Kushtetutë. Si rrjedhojë, kërkesa në fjalë nuk mund të merret në shqyrtim meqë nuk plotëson asnjë nga kushtet procedurale të përcaktuara me Kushtetutë, Ligj dhe Rregullore të punës.
22. Si përfundim, Gjykata konstaton se kërkesa duhet të refuzohet në pajtim me rregullin 32 (5) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 113.1 dhe 7 të Kushtetutës dhe rregullin 32 (5) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 15 shtator 2016, njëzëri

VENDOS

- I. TA REFUZOJË kërkesën me procedurë të shkurtër;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20. 4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Selvete Gërxhalin-Krasniqi

Arta Rama-Hajrizi

